



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:047674

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05381919

P.nr. 47/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN –dega V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me zyrtaren ligjore Jehona Zuzaki-Dauti, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.D. nga fshati K. Komuna V., për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare Av. E.S. nga V.a, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.297/23 e dates 13.03.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik të datës 21.02.2024, me datë 26.02.2024 mori, shpalli, dhe me datë 27.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **F.D.**, nga babai G., nëna F., e lindur Ademi, i lindur me dt. 15.04.1967 në fshatin K., Komuna V., ku dhe jeton, i martuar, babë i 2 (dy) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal 1005462700, lëshuar nga MPB Prishtinë.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse, me datë 18.01.2023 rreth orës 10:10 min, në rrugën "Brigada 173" në V., i pandehuri F.D., ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerzëve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që derisa drejtonte automjetin e markës Citroen C3, me tabela te regji. 06-390-DM, nga pakujdesia dhe në kundërshtim me nenin 53 paragrafin 1 dhe 149 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, nuk e përshtat shpejtësin dhe kushtet e rrugës si dhe duke mos respektuar përparësin e kalimit të këmbësoreve në vendkalim të paraparë për këmbësor, i cili me pjesën e përparme të veturës së tij e godet këmbësorin, tani të dëmtuarin M.S., i cili në ato momente ka qenë duke e kaluar rrugën, kështu që nga ky aksident lëndime të rënda trupore pëson i dëmtuari M.S., në formë te nderydhjeve të indeve të buta në regionin e parakrahut, thyerje e kockës së kërcirit të djathtë dhe gërvishje, i cili për shkak të lëndimeve të pësuar është detyruar të kërkoj ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regional në Gjilan.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 40, 42, 48, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 242 paragrafi 2, pika 2.1; 2.2; 2.3; 2.4 të KPPRK-së dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit F.D., i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit F.D.për veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi i shqitohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindëtetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht nëse i pandehuri në periudhën e verifikimit prej 1 (një) V., duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari M.S.nga V.a, rr. "UÇK", nr. 184, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. Mustafë Musa, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

REFUZOHET propozimi i Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm që të pandehurit F.D. i shqitohet dënimi plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 (njëzet) €, shumën 20.00 (njëzet) € për ekspertizë mjeko-ligjore dhe shumën 140.00 (njëqindëekatërdhjetë) € për ekspertizë të komunikacionit, dhe shumën prej 20.00 (njëzet) € për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rriedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me date 15.03.2023, në Gjykatën Themelore në Gjilan Dega në V. ka dorëzuar aktakuzën, me numër PP.II.nr.297/23 e dt 13.03.2023, ndaj të pandehurit F.D., për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Me datë 21.02.2024 gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, i dëmtuari M.S., përfaqësuesi i të dëmtuarit M.S., sipas autorizimit av.Mustafë Musa, i pandehuri F.D.dhe mbrojtësi i të pandehurit, sipas detyrës zyrtare Av.Edison Simani. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuriri F.D.ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, i cili pranim i fajësisë ishte vullnetar, pa ndikim dhe pas konsultimeve të nevojshme me mbrojtësin e tij.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit M.S., sipas autorizimit Av. M.M.ka deklaruar: nuk i bashkangjitemi ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe kërkesën pasurore juridike do ta realizojmë në procedurë konstestimore apo administrative.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2, pika 2.1; 2.2; 2.3; 2.4 të KPPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit F.D.për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: raporti mbi aksidentin, raportit i hetuesit Ismaj Huruglica, deklarata e të pandehurit F.D., deklarata e të dëmtuarit M.S., fotot nga vendin i ngjarjes, fletëleshimi nga Spitali Regjional i Mitrovicës, me nr. 175, i dt 30.01.2023 në emer të të dëmtuarit Mitar Stanojoviq, alkooltesti i të pandehurit F.D., raportit mjekësor me nr 1535 i dt 18.01.2023 në emeër të të dëmtuarit Mitar Stanojoviq, e lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Regjional ne Gjilan, ekspertiza mjeko ligjore me nr. te ref GL-09 e dt 08.03.2023, eksperiza e komunikacionit, e datës 27.02.2023, nje CD, si dhe shkresat tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri F.D.ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 242 paragrafi 2, pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindëtetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht nëse i pandehuri në periudhën e verifikimit prej 1 (një) V., duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, vepra penale është kryer nga pakujdesia, është hera e parë ka rënë ndesh me ligjin, gjendja e varfër ekonomike, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, i ka ofruar ndihmë të dëmtuarit menjëher pas aksidentit, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, deklarin e përfaqësuesit të të dëmtuarit se nuk i bashkangjiten ndjekjes penale ndaj të pandehurit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin shkallën e rrezikshmërisë shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit. Andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron dënimin i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimin i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së.

6.Vendimi për refuzimin e shqiptimit të dënimit plotësues

Sa i përket shqiptimit të dënimit plotësues nga neni 59 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 të KPRK-së, ndalimi i drejtimit të automjetit gjykata konsideron se shqiptimi i këtij dënim do të mund të ndikonte negativisht tek i njëjti në përmbushjen e obligimeve familjare ndaj anëtarëve të tjerë të familjes së tij, pasi që është i vetmi që posedon patent shofer, po ashtu gjykata para se të vendos lidhur me këtë propozim çmoi se me asnjë nga provat e paraqitura në aktakuzë nuk mund të konstatohet se pjesëmarrja e mëtutjeshme e të pandehurit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit, ngase sipas shkresave të lëndës shihet se për të njëjtin është hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht hera e parë që i njëjti ka kryer veprë të tillë andaj duke marrë parasysh rrethanat e lartcekura gjykata vendosi që një propozim të tillë ta refuzojë.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

I dëmtuari M.S.nga V.a, rr. "UÇK", nr. 184, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, në kuptim të nenit 462 paragrafi 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 451 dhe 452 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale, siq janë: paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet), shumën 20 (njëzet) € për ekspertizë mjeko-ligjore, shumën 140 (njëqindëekatërdhjetë) € për ekspertizë të komunikacionit, dhe shumën prej 20€ (njëzet) € për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.47/2024, i datës 27.02.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.